



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

---

Nr. 4/2 Prot.

Tiranë, më 22/4 /2011

**Lënda:** Rekomandim për **“INTERSIG” sh.a**

**REKOMANDIM**

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **“INTERSIG” sh.a** ,

**KONSTATOVA**

Më datë 07.02.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar hetimi administrativ pranë kontrolluesit, **“INTERSIG” sh.a** , me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive të parashikuara në nenet 5,6,7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Transferimi ndërkombëtar i të dhënave parashikuar në nenet 8,9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” .
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Siguria e të dhënave personale, kategoria e mjeteve të përpunimit që përdoren, masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27)
- Plotësimi i detyrimit për njoftim ( neni 21).

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e hetimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi “Intersig” sh.a nuk ka kryer plotësisht detyrimin ligjor për njoftim pranë Komisionerit sipas nenit 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
  - Në formularin e njoftimit nuk janë deklaruar mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për kategoritë “aplikant” (kandidatët që aplikojnë për tu punësuar pranë kontrolluesit) dhe kategorinë “furnizues”.
  - Nuk ka deklaruar mbledhjen, përpunimin e të dhënave sensitive për kategoritë “klientë” dhe “punonjës”.
  - Nuk ka deklaruar në formularin e njoftimit përhapjen e të dhënave personale tek të tretë.
  - Nuk ka deklaruar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale drejt shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe shteteve që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.
- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ...“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë”.
2. Kontrolluesi “Intersig” sh.a ruan dhe administron në arshivë fizike dosje me dokumentacione që mbartin të dhëna personale për punonjësit që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë kompani.
  - Në këtë rast nuk është zbatuar neni 5 pika 1/d i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... “Në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.
  - Nuk është zbatuar neni 27/4 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”...“Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është e nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar”.
3. Kontrolluesi “Intersig” sh.a nuk ka të përfshirë në rregulloren e brendshme, të hartuar prej tij, rregulla të veçanta lidhur me mbrojtjen dhe kofidencialitetin për të dhënat personale. Kontrolluesi “Intersig” sh.a. përdor sisteme CCTV të video vëzhgim-regjistrimi në ambiente të tilla si: hyrja në godinë, korridore, departamente të rëndësishme , “Departamenti i Demeve” etj. Ambientet e godinës ishin të sigurta dhe të

gjitha hyrjet dhe daljet kontrolloheshin në rrugë fizike (roje dhe reception) si dhe monitoroheshin me sistem video vëzhgimi ( CCTV).

Kontrolluesi “Intersig” sh.a nuk ka të dokumentuara, të vendosura procedura të qarta për të përcaktuar përdorimin e këtij sistemi në praktikë, ku të ketë të identifikuar dhe përcaktuar qartë qëllimin specifik për përdorimin e këtij sistemi dhe të dhënave personale që do të mblidhen, përpunohen e do të trajtohen në praktikë ( udhëzime për vënien në dispozicion të regjistrimeve dhe mënyrën e ruajtjes së tyre, kohën e ruajtjes, aksesin etj).

Sipas tyre qëllimi i përdorimit të këtij sistemi është **për efekt të sigurisë** dhe se kapaciteti i ruajtjes se imazheve në DVR është 14 ditë me riciklim. Në këto të dhëna ka akses të plotë Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit si dhe Drejtoresha e Përgjithshme. Videot mund të aksesohen në një ndërfaqe ëebi. Për videot nuk aplikohet procedura “*backup\_i*”.

Në lidhje me punonjësit që punojnë në departamente, zyra të monitoruara në kohë reale nëpërmjet sistemit të video survejimit gjatë gjithë kohës së punës kontrolluesi ka realizuar informimin e tyre duke vendosur tabela paralajmëruese për monitorimin e ambienteve me kamera dhe nga intervistimet u deklaruan se punonjësit informoheshin për këtë fakt edhe gojarisht.

Kontrolluesi “Intersig” sh.a gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të videosurveimit (CCTV) nuk respekton afatin prej 7-ditësh të ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave (ka vendosur një afat 14-ditor) të parashikuar në udhëzimin nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e videosurvejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”

Kontrolluesi mund të përdorë sistemin e video survejimit nëse kjo është e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe të pronës, për të siguruar dhe mbikëqyrur hyrjet dhe daljet në ndërtesë, ose nëse natyra e punës mund të sjellë një kërcënim potencial për kontrolluesin. Në këtë rast, kontrolluesi duhet të ketë një vendim të shkruar, ose të jetë e parashikuar në kontakt, ku të shpjegojë arsyet pse do të futet në përdorim sistemi i video survejimi, qëllimi dhe mënyra e përdorimit të tij në ambientet e punës ose ambiente të tjera (korridore). Gjithashtu, ai duhet të konsultohet me përfaqësuesin e sindikatës të punëtorëve si dhe duhet të njoftohen punonjësit që ambientet survejohen me kamera.

Kamerat e sigurisë (video survejimet) vendosen vetëm për të mbrojtur sigurinë e njerëzve dhe të pronës, prandaj është i lejuar vetëm monitorimi i hyrjeve dhe daljeve. Nga të cilat kontrolluesi mund të arrij qëllimin e tij lidhur me sigurinë.

Kamerat e sigurisë mund të vendosen në ambientet e punës vetëm nën kushtet dhe mënyrën e parashikuar nga ligji. Ato mund të vendosen vetëm në raste të veçanta, kur nevojitet për sigurinë e njerëzve dhe pronës dhe kur ky qëllim nuk mund të arrihet me mënyra të tjera më të arsyeshme. Për këtë arsye, kamerat e sigurisë mund të vendosen vetëm në ambientet e punës që duhen vëzhguar për arsye sigurie.

Qëllimi themelor për përdorimin e video survejimit, konsiston në faktin se, ai është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të kontrolluesit, i cili së pari nuk duhet të shkelë privatësinë dhe të keq përdorjë të dhënat personale të punonjësve.

Çdo punonjës ka të drejtën të gëzojë një shkallë të caktuar privatësie në punë. Qëllimi për të cilin përfaqësuesit e kontrolluesit deklaruan gjatë intervistimit, mund të realizohet mjaftueshëm me vendosjen e kamerave të regjistrimit në hyrjet- daljet e ambienteve të punës së kontrolluesit dhe nuk është e nevojshme përdorimi i tyre në korridore apo në brendësi të zyrave të punonjësve.

Është e panevojshme që sistemi i video survejimit të përdoret në këto ambiente pasi kemi të bëjmë me një lloj interferimi në jetën private të punonjësve.

Përdorimi i video regjistrimeve në zyra dhe korridore nuk është i nevojshëm për qëllime sigurie, pasi punonjësit dhe klientët që futen në këto zyra nuk përbëjnë një shkallë të lartë rreziku (për vetë natyrën e punës) sa të justifikohet përdorimi i videosurvejimit në këto ambiente, për më tepër vendosja e sistemit të videosurveimit në këto ambiente mund të përdoret për qëllime të tjera nga kontrolluesi duke prekur në këtë mënyrë privatësinë e punonjësve që punojnë në këto zyra dhe klientëve që paraqiten pranë këtyre punonjësve.

Në këto kushte, konsiderohet si jo proporcionale me qëllimin për të cilin është instaluar përdorimi i video kamerave (CCTV-ve) në zyrën e dëmeve dhe ambientet e korridoreve të ndërtesës së Kontrolluesit “Intersig” sh.a, si një mungese e theksuar e ruajtjes së jetës private, dinjitetit, pavarësisë, vlera këto të shprehura në “Deklaratën e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut” dhe parimit të mjaftushmerisë të shprehur në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- Në këtë rast nuk është zbatuar udhëzimi Nr.3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e videosurvejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”.

4. Kontrolluesi “Intersig” sh.a nuk ka të përfshirë në rregulloren e brendshme, të hartuar prej tij, rregulla të veçanta lidhur me mbrojtjen dhe kofidencialitetin për të dhënat personale.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27/2 “c”... “*udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshire dhe rregullat për sigurinë e të dhënave*”...
- Nuk është zbatuar neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “*Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë kofidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj*”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ

- 1) Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, kontrolluesi “**INTERSIG**” sh.a duhet të riformuloj Formularin e njoftimit duke deklaruar:
  - Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë *“aplikant”* (kandidatët që aplikojnë për tu punësuar pranë kontrolluesit) dhe kategorinë *“furnizues”*.
  - Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave sensitive për kategorinë *“klientë”* dhe kategorinë *“punonjës”*.
  - Përhapjen e të dhënave personale tek të tretët
  - Transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale drejt shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe shteteve që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.
  
- 2) Në zbatim të nenit 5 pika1/d dhe nenit 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, kontrolluesi “**INTERSIG**” sh.a duhet të asgjesojë nga arshivat fizike dosjet me dokumente që mbartin të dhëna personale, për kategorinë punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë kontrollues.
  
- 3) Në zbatim të nenit 5 pika1/c të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* dhe udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Mbi sistemin e videosurvejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”*, kontrolluesi “**INTERSIG**” sh.a
  - Të ndalojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të CCTV në departamentin e dëmeve dhe korridoret e godinës, duke hequr prej tyre kamerat vëzhguese.
  
- 4) Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, kontrolluesi “**INTERSIG**” sh.a duhet të hartojë rregullore për përdorimin e sistemit të CCTV-ve, ku të vendosen procedura të qarta, qëllimet specifike, mënyra e përpunimit, ruajtja e të dhënave personale, personat përgjegjës për të siguruar ndjekjen e këtyre procedurave, aksesit, e drejtat e individit për informim etj.
  
- 5) Në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, kontrolluesi “**INTERSIG**” sh.a duhet të përfshijë në rregulloren e brendshme që është duke hartuar një seksion të vecantë për kofidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

